



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.9.dt.28.01.2000

**PER  
KALIM NE FOND BANESE, PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV DHE  
PRIVATIZIM**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës në mbledhjen e tij të datës 28.01.2000 pasi mori në shqyrtim relacionin e përparitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Srehimit), “Për kalim në fond banese, pajisje me autorizim definitiv dhe privatizim” të një objekti të ish repartit ushtarak Nr.5858, në zbatim të ligjit 7572 dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, si dhe të V.K.M. nr.153 dt.03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetore”, të VKM Nr.49 dt.23.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët” si dhe Dekretit të Presidentit Nr.1440 dt.04.04.1996 “Për trajtimin e banesave shtetore të paprivatizuara”

**V E N D O S I**

1. Të miratojë kalimin në fond banese të objektit ish repartit ushtarak Nr.5858 që ndodhet në rajonin e aerodromit Laprakë (sipas genplanit bashkëngjitur) në të cilën banojnë familjet Vasha ish të përndjekur politikë
2. Të pajisen me autorizim definitivë familjet Vasha (sipas planimetrive bashkëngjitur) si më poshtë:

Durim Vasha – banon në një dhomë dhe korridor të përbashkët, i pastrehë

Përparim Vasha – banon në një dhomë dhe korridor të përbashkët, i pastrehë

Bashkim Vasha – banon në një dhomë e kuzhinë, i pastrehë

Ismail Vasha – banon në një dhomë e kuzhinë, i pastrehë

Pashako Vasha – banon në dhomë e kuzhinë, i pastrehë

Xhelal Vasha – banon në dy dhoma e kuzhinë, i pastrehë

3. Kryefamiljarët dhe personat e tjerë madhorë të çdo familje përpara se të marrin autorizimin definitiv të bëjnë një deklaratë noteriale që në rast të ndërtimeve sipas studimit urbanistik të zonës heqin dorë nga pronësia mbi këtë banesë për tu sistemuar me banesat e tjera sipas studimit
4. Të miratojë privatizimin e këtyre banesave (sipas strukturës për secilën familje) si banesa të kategorisë së tretë, por jo truallin
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike (Drejtoria e Ndërtim Strehimit)
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**



